REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS
FINANCA

Nr. 1054 Prot. Date 22/09/2026.

Lenda : Relacion për Projekt Vendimin Nr.17 Date 22.09.2026 Rishpërndarje në buxhetin e Bashkisë Has në transfertën e pakushtezuar për vitin 2026.

Bazuar në, Ligjin Nr.139/2015, date 17.12.2015 "Për Veteqeverisjen Vendore", Ligjin Nr.68/2017 "Per Financat e Veteqeverisjes Vendore", Ligjin Nr.9936, date 26.06.2008 "Per Menaxhimin e Sistemit Buxhetor ne Republiken e Shqiperise" i ndryshuar, Ligjit Nr. 87/2025 per buxhetin e vitit 2026", Udhëzimit Plotësues Nr.2 datë 14.01.2026 "Për zbatimin e buxhetit 2026", paraqitet për miratim Rishpërndarja e fondeve buxhetore e vitit 2026; ky projektvendim synon të mundësojë përdorimin sa më efektiv të fondeve buxhetore në dispozicion, në përputhje me nevojat e njësive shpenzuese dhe prioritetet e institucionit, duke siguruar mbulimin e nevojave për shpenzime të domosdoshme gjatë zbatimit të buxhetit të vitit 2026. Rishpërndarja e propozuar realizohet brenda fondeve të transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme të Bashkisë Has për vitin 2026.

1. Pakësimi i fondeve

Sipas projektvendimit, propozohet pakësimi i fondeve në disa programe dhe llogari ekonomike, për një vlerë totale prej: **17,253,835 lekë.**

Pakësimet përfshijnë fonde të planifikuara për blerje automjeti për Policinë Bashkiake, paga dhe sigurime shoqërore, shpenzime kancelarie, mirëmbajtje, pastrim kanalesh, emergjenca civile, rikonstruksion çatie dhe shpenzime të tjera të parashikuara në buxhet.

Këto fonde do të rishpërndahen drejt zërave të tjerë buxhetorë, me qëllim përmbushjen e nevojave të evidentuara gjatë zbatimit të buxhetit.

2. Shtesa e fondeve

Në kuadër të rishpërndarjes, propozohet shtimi i fondeve në programe dhe llogari ekonomike të për një vlerë totale prej: **17,253,835 lekë.**

Shtesat parashikohen për financimin e nevojave të mëposhtme:

- Aktivitet kulturor panairi;
- Energji elektrike;
- Shërbim telefonik;
- Ujësjellës;
- Paga dhe sigurime shoqërore;
- Shpenzime të lidhura me funksionimin e programeve të ndryshme;
- Studim-projektim për rrugën Cahan.

Rishpërndarja e fondeve për këto zëra synon të sigurojë vijueshmërinë e shërbimeve publike, përmbushjen e detyrimeve të institucionit dhe realizimin e objektivave të përcaktuar në buxhetin e vitit 2026. Miratimi i këtij projektvendimi do të mundësojë sistemimin e fondeve buxhetore sipas nevojave të evidentuara dhe realizimin e shpenzimeve të planifikuara gjatë vitit 2026.

Faleminderit per bashkepunimin

Grislanda Bajraktari
Përgjegjëse Finance

Aida Bera
Përgjegjëse Juridiku

Sahit Meshi
Drejtor Finance

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA HAS

KRYETAR
Muhar DAUDI